



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



Departamenti i Sistemeve të Pagesave  
33 Garibaldi, Prishtinë 10000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 244 410  
[payment.systems@bqk-kos.org](mailto:payment.systems@bqk-kos.org)  
[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

Departamenti i Sistemeve të Pagesave

**Paraja** - tregon vlerën e secilit mall.

Është vështirë të paramendohet si do të ishte e organizuar jeta po të mos ekzistonte paraja, si do të blinim, paguanim gjërat.

Me zhvillimin e njerëzimit paraja ka ndryshuar deri në ditët e sotme. Kambiali, çeku, letër debi, urdhërpagesa, urdhërpagesa periodike, janë mënyra tradicionale të zëvendësimit të parasë.

Sot me zhvillimin e teknologjisë, informatikës dhe telekomunikimeve janë në dispozicion mënyra të tjera, të cilat mundësojnë transferim pa përdorimin e parasë së gatshme. Emëruesi i përbashkët i këtyre formave bashkëkohore është paraja elektronike.

**Paraja Elektronike** - definohet si vlerë monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emetuesit, që emetohet pas pranimit të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet, si mjet i pagesës nga personat e tjerë përveç emetuesit.

Cilat janë përparësitë e përdorimit të parasë elektronike?

**Lehtësi** - transaksionet kryhen në çdo kohë, pa u brengosur për orarin e punës së bankave dhe sporteve,

**Shpejtësi** - transaksionet kryhen dhe konfirmohen më shpejtë online,

**Efikasitet** - lehtësi e qasjes dhe operimit online me të gjitha llojet e transaksioneve bankare tuaja, si: depozita, pagesat, investime etj.

Nuk kufizoheni me vendndodhjen e bankës tuaj, përdorim nga kudo që të ndodheni përmes ATM/POS, e-banking etj.

Kosto më e ulët për bankën dhe për përdoruesin, kursim në kohë.

Eliminon nevojën e bartjes së parasë së gatshme, eliminon rrezikun e humbjes, grabitjes, falsifikimit, mashtrimit.

Shembuj të përdorimit të parasë elektronike janë: përmes sporteve automatike (ATM), pikave të shitjes (POS), përmes e-banking-ut, etj.

Format më të zakonshme të përdorimit të parasë elektronike sot:

**Transferet e kreditit** - Udhëzim nga paguesi, bankës së tij që të debitojë llogarinë bankare të tij dhe t'ia kreditojë llogarinë bankare përfituesit të fondeve.

**Kartelat bankare** - Kartela që lëshohen nga bankat komerciale (emetuesi) i japin mundësi klientit të paguajë me fondet nga llogaria bankare e tij. Llojet e kartelave më të përhapura në Kosovë janë ato të rrjeteve ndërkombëtare VISA, MasterCard.

**Debit Kartela** - I mundëson klientit që të kryejë pagesa dhe të tërheqë para të gatshme nga llogaria bankare e tij, deri në vlerën e fondeve të cilat i ka në llogari.



**Kredit Kartela** - I mundëson klientit të kryejë pagesa edhe pse nuk ka mjete në llogari, duke shfrytëzuar kredinë e lejuar nga banka në bazë të marrëveshjes paraprake. Për mjetet e shfrytëzuara klienti i paguan bankës interes.



**Kartela me parapagim** - Klienti ka në dispozicion një shumë të caktuar të parave për përdorim.

**E-banking** - I mundëson klientit qasje në llogarinë e tij dhe kryerjen e pagesave përmes internet portalit të bankës

**Mobile banking** - I mundëson klientit kryerjen e një numri të transaksioneve nga llogaria e tij bankare përmes përdorimit të telefonave mobil.

**Urdhërpagesa periodike** - I mundëson klientit të urdhëroj bankën e tij të kryejë pagesat e rregullta në intervale të caktuara kohore në shumë të caktuar.

**Debitimi Direkt** - I mundëson klientit që në bazë të marrëveshjes paraprake, të autorizojë bankën e tij (përmes kompanisë përfituese) që të bëjë pagesa të rregullta nga llogaria e tij në llogarinë e përfituesit.

Për DEBITORIN		Sistemi i Pagesave Ndërbankare		Emërtimi dhe logo e kreditit	
	Debitim Direkt në SPN				
	Numri unik i referencës së autorizimit (12 pozitosh nga krediti)				
Me autorizimin e këtij autorizimi orë:					
A. Autorizim tërësisht i kreditit të këtij karti bankare të emetuar për debitimin e Digital Home, dhe					
B. Autorizim bankare tërësisht i kreditit të këtij karti bankare të emetuar për debitimin e kreditit.					
Ja këtu të drejtë të kërkesës së pagesave nga banka, por sipas kushteve të marrëveshjes me bankën tuaj.					
Kërkesa për llogaritje të detyrueshme të vlerës së pagesave të detyrueshme të llogaritjes tuaj.					
Të drejtat tuaja për të marrë në deklarim të cilin mund të marrë në bankën tuaj.					

**Pagesa Giro** - I mundëson klientit të kryejë pagesën e detyrimit ndaj kompanive publike përmes faturave standarde me mundësi leximi automatik përmes lexuesve të barkodeve.

